



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

### Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë

Tiranë, më 19. 11. 2019

Dokument parlamentar

**(Komision për dhënie mendimi)**

## RAPORT

### PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2020” NË PARIM

Drejtuar: Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në mbledhjet e tij të datës 18 nëntor 2019, shqyrtoi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”, në parim.

Të ftuar për të marrë pjesë në mbledhjen e shqyrtimit në parim të këtij projektligji dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve ishin: Ministrja i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrja dhe zv. Ministrja e Ekonomisë dhe Financave, si dhe specialistë të këtyre dy ministrive.

Ky komision, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 32-39 dhe 80 të Rregullores, shqyrtoi projektligjin “Për Buxhetin e vitit 2020”, për pjesën që shprehet për shpenzimet dhe të ardhurat për këto ministri.

#### **Për Ministrinë e Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale**

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u shpreh, se, buxheti i planifikuar për këtë ministri për vitin 2020, i mbulon të gjitha nevojat për programet buxhetore dhe për realizimin e programit politik qeverisës dhe se, ky buxhet, për vitin 2020 (përfshirë kontributet shëndetësore) parashikohet të jetë (77,735,940 mijë lekë), ndërsa në vitin 2019 kaqenë 74,750,877 mijë lekë.

Kështu, buxheti i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2020 ka pësuar një rritje në masën 4 %, në krahasim me vitin 2019.

Kontributet shëndetësore për vitin 2019 janë 13,730,000 mijë lekë dhe për vitin 2020 (14,416,000 mijë lekë) me një rritje prej 5% krahasuar me 2019 dhe transferta buxhetore për FSDKSH për vitin 2020 është 29,684,000 mijë lekë. Totali i buxhetit për FSDKSH për vitin 2020 është 44,100,000 mijë lekë.

Për vitin 2019 niveli i shpenzimeve korrente është 57,890,877 mijë lekë dhe për vitin 2020 është parashikuar 60,209,940 mijë lekë me një rritje prej 4 % krahasuar me 2019.

Krahasuar kundrejt PPB dhe Buxhetit të Shtetit, shpenzimet e buxhetit të MSHMS për vitin 2020 janë 4.33 % të PBB dhe kundrejt Buxhetit total të Shtetit, shpenzimet e buxhetit të MSHMS për vitin 2020 përbëjnë 14.61% të PBB.

Shpenzimet për shëndetësinë në vitin 2019 janë 49,906,963 mijë lekë (me kontributet shëndetësore) dhe për vitin 2020 buxheti total është parashikuar 52,675,780 mijë lekë (me kontributet shëndetësore), me një rritje prej 5.54 % krahasuar me 2019.

Shpenzimet për mbrojtjen sociale në vitin 2019 janë 23,596,614 mijë lekë ose 1.38 % e PPB dhe për vitin 2020 janë parashikuar (24,012,960 mijë lekë) me një rritje prej 1.76 % krahasuar me 2019.

Totali i investimeve të parashikuara për MSHMS për vitin 2020 është 3,110,000 mijë lekë.

Përsa i përket programit të kujdesit dytësor do të finalizohet Faza e II e rehabilitimit të QSUT me fonde të CEB (Banka e Keshillit të Evropës) dhe Qeverisë Shqiptare me një agregat financimi prej 23 milion EUR. Ndërhyrjet në kuadër të këtij projekti përfundojnë në mesin e vitit 2021.

Në programin e shëndetit publik do të kemi pajisje të reja diagnostikuese për laboratorët e Institutit të Shëndetit Publik, pajisje për rrezatimin jo jonizues të zyrës së mbrojtjes nga rrezatimi dhe përmirësimin infrastrukturor të disa prej godinave ku ushtrojnë aktivitetin njësitë vendore të kujdesit shëndetësor në vlerë 23.5 milionë lekë;

Në programin e urgjencës mjekësore do kemi fuqizimin e shërbimit të urgjencës mjekësore 24/7 në territor nëpërmjet blerjes së pajisjeve të reja mjekësore për autoambulancat e shërbimit të urgjencës në vlerën 25.8 milionë lekë.

Në programin e përkujdesjes sociale shpenzimet kapitale për këtë program parashikohen 37,7 milion lekë për pajisje mobilimi për institucionet e përkujdesjes sociale (23 milion lekë), si dhe pagesa TVSH (14.7 milion lekë). Gjithashtu në këtë program për vitet 2020 në zërin “Financimi i Huaj” është programuar vlera prej 100 milionë lekë (kryesisht projekti i financuar nga Banka Botërore “Modernizimi i Asistencës Sociale”).

Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale, janë në rishikim të vazhdueshëm strukturat e personelit të qendrave shëndetësore në të gjithë vendin, në funksion të mbulimit sa më të mirë të popullatës me këtë shërbim shëndetësor. Në buxhetin për shërbimin parësor është përfshirë buxheti për paga e sigurime i personelit të qendrave, plotësimi i nevojave për mallra e shërbime të këtyre qendrave, si dhe është llogaritur buxhet për të përballuar nevojat e qendrave që vihen në vështirësi gjatë sezonit dimëror. Po kështu, është përlllogaritur buxhet edhe për mbulimin e sezonit veror për qendrat turistike. Përlllogaritur kështu një parashikim total prej 90 milionë lekë.

Gjithashtu, është parashikuar një buxhet prej 876,083 mijë lekë për përballimin gjithëvjetor të shpenzimeve për kontrollin bazë të popullsisë 35 deri 70 vjeç, në zbatim të VKM Nr.

185, datë 2.4.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së realizimit të kontrollit mjekësor bazë për shtetasit e moshës 40-65 vjeç”, i ndryshuar (sipas kushteve të kontratës konçensionare, minimalisht 475 mijë raste në vit, të pagueshme).

Shuma totale e shpenzimeve për financimin e shërbimit shëndetësor parësor është parashikuar të jetë 8,321,138 mije leke (2020), ku vetem financimi nëpërmjet FSDKSH është 7,545,862 mijë lekë.

Parashikimi i numrit të vizitave në kujdesin shëndetësor parësor është bazuar në treguesit e sëmundshmërisë. Në periudhën 2020-2022 parashikohen rreth 6.4 milion vizita për secilin vit. Kosto totale e këtyre vizitave, pjesërisht e mbuluar nga transfertat e buxhetit për periudhën në fjalë parashikohet të jetë respektivisht në vitin 2020 3,374,858 mijë lekë (2020). Ky produkt financohet, përveç transfertës së buxhetit, edhe nga kontributet e arkëtuara të sigurimeve shëndetësore.

Aktualisht përfitojnë rreth 400.000 pacientë të trajtuar me recetë me rimbursim. Për vitet e PBA parashikohet që sëmundshmëria e trajtuar nga kjo listë të rritet me rreth 6% në vit. Për këtë produkt kosto e politikave ekzistuese nga transfertat e buxhetit për vitin 2020 është 4,775,379 mijë lekë. Ky produkt financohet gjithashtu nga kontributet e sigurimeve shëndetësore, pjesë e buxhetit të FSDKSH. Kufiri maksimal i shpenzimeve prej 10.5 miliard lekë për shpenzimet e rimbursimit të barnave për vitin 2019, si dhe rritja e sëmundshmërive me një ritëm prej të paktën 6% në vit, kufizojnë jo vetëm politikën lidhur me futjen e barnave të reja në liste dhe për pasojë mbulimin e një game me të gjere diagnozash e sëmundshmërie.

Fondi gjatë vitit 2019, ka zgjeruar mbulimin shëndetësor të popullsisë me pajisje mjekësore. Konkretisht nisur nga muaji Prill 2019, realizohet pajisja me fisha diabeti për grupmoshën nga 0 deri 25 vjeç (nga 0 deri 18 vjeç që mbulohej nga fillim viti 2018), duke shtuar fashën e mbulimit nga skema të popullatës në nevojë për këtë paketë.

Në Programin e Përkujdesjes Sociale janë parashikuar:

- i. Familje dhe individë në nevojë që përfitojnë nga skema e NE, në total për vitin 2020 parashikohen 4.5 miliardë lekë,
- ii. Familje Rome dhe Egjiptiane në nevojë që përfitojnë nga skema e NE, produkt i parashikuar në zbatim të pikës 4 të Deklaratës së Ballkanit Perëndimor për Integrimin e Romëve, brenda Procesit të Zgjerimit të BE-së, firmosur në Samitin e Poznan, Korrik 2019, nga Kryeministrat e Rajonit., ku aktualisht përfitojnë 2,640 familje Rome dhe Egjiptiane me një buxhet prej 190 milion lekë, ndërsa për vitin 2020 parashikohet një rritje e numrit prej 6 % .
- iii. PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa. Numri i tyre parashikohet të jete objektiv, duke ulur abuzimet si rezultat i mireadministrimit të programit të pagesave të aftësisë kufizuar si dhe zbatimit skemës së re të vlerësimit sipas modelit bio-psiko-social, bazuar në standardet e Organizatës Botërore të Shëndetit. Ky sistem i ri vlerësimi synon krijimin e një sistemi shërbimesh integruese, të cilat kombinojnë pagesat me shërbimet e përkujdesit social. Përfitimet e aftësisë së kufizuar do të rishikohen dhe do të mundësohet mbështetja me pagesa më të larta të atyre individëve më aftësi të kufizuar që kanë një gjendje shëndetësore më të rënduar dhe që kanë më shumë barriera për tu përfshirë në jetën shoqërore. Në total, për këtë produkt, sipas viteve të PBA parashikohen fondet 16,405,140 mijë lekë (2020) për 166 mije përfitues.

- iv. Bonusi i Bebes. Që nga 1 janari i 2019, qeveria shqiptare ka inicuar shpërblimin e lindjes (i diferencuar sipas numrit të fëmijve të lindur nga nena: 40,000 lekë për fëmijën e parë, 80,000 lekë për të dytin, 120,000 lekë për fëmijën e tretë e më shumë). Për tre vitet (2020-2022) parashikohen rreth 30 mijë lindje. Shpenzimet për këto tre vite në kuadër të Bonusit të Bebes për vitin 2020 janë parashikuar 2,000,000 mijë lekë.
- v. Monitorimi për mbrojtjen e fëmijëve. Ky produkt paraqet buxhetin e Agjencisë së Mbrojtjes të Drejtave të Fëmijëve me një vlerë totale prej 9,860 mijë lekë në vitin 2020.

Për Programin e Përkujdesjes Sociale kemi planifikuar **politika të reja** të cilat janë brenda tavaneve të miratuara. Politikat e reja parashikojnë:

- i. Modelimin e ndërmarrjeve sociale si program alternativ riintegrimi për grupet e pafavorizuara. Synimi kryesor është integrimi në tregun e punës të kategorive të ndryshme të grupeve të pafavorizuara nga pikëpamja sociale dhe ekonomike përmes rregullimit të formave të mbështetjes së ndërmarrjeve sociale.
- ii. Ngritjen e shërbimeve të reja të përkujdesit social nëpërmjet financimit nga Fondi Social.

Numri i personave që parashikohet të përfitojë për vitin 2020 është 200 persona të punësuar nga kategoritë në nevojë (prioritet familjet përfutuese të skemës së ndihmës ekonomike). Në total për këtë produkt për vitin 2020 parashikohet fondi 150,000 mijë lekë.

Përfutues të shërbimeve të përkujdesit social të ofruara në qendrat rezidenciale publike. Ky tregues përfshin shërbimet e përkujdesit social që përfitojnë në qendrat rezidenciale publike të përkujdesit social fëmijët në nevojë, të moshuarit në nevojë, gratë e dhunuara, gratë dhe vajzat në rrezik trafikimi. Numri i personave që përfitojnë parashikohet të ulet si rezultat i deinstitutionalizimit, pasi fillimisht synohet transformimi i institucioneve dhe jo shkurtim buxhetor. Parashikohen tipologji të reja dhe shërbime alternative për kategoritë në nevojë. Numri i përfutuesve parashikohet të jete 1,170 për vitin 2020 dhe janë parashikuar 932,000 mijë lekë.

Programi Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë. Përfshin pagesën që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kryen për këtë kategori bazuar në listat që Ministria e Financave dhe Ekonomisë dërgon. Ky program ka të kostuar këto produkte:

- i. Pagesat e dëmshpërblimit të ish të përndjekurve politikë. Kostot për vitet e PBA
- ii. (2020-2022) janë respektivisht nga 1.000.000 mijë lekë për çdo vit.
- iii. Ish të përndjekur politikë të rehabilituar dhe integruar. Kostot për vitet e PBA (2020-2022) janë respektivisht 50.000 mijë lekë për çdo vit .

### **Për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë**

Ministrja dhe zëvendesministrja e kësaj Ministrie dhe përfaqësuesit e saj, shpjeguan nëpërmjet një informacioni përmbledhës të detajuar mbi buxhetin e Programeve të Punësimit dhe Formimit Profesional për vitin 2019.

Në zbatim të Programit dhe objektivave strategjike të Qeverisë, Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019 – 2022, si dhe të buxhetit vjetor të shtetit për tregun e punës, AKPA zbaton programet:

## **Programi i ndërmjetësimit për punë**

Ndërmjetësimet e zyrave të punësimit mundësojnë që punëkërkuarit e papunë të gjejnë punën më të mirë të mundshme dhe, gjithashtu ndihmon punëdhënësit të gjejnë kandidatin më të përshtatshëm. Nëpërmjet këtij programi në vitin 2020 është planifikuar të realizohet një profilizim më të mirë të punëkërkuarve përmes sistemit të rinovuar të informacionit të AKPA dhe hartimit të planeve individuale të punësimit.

Për vitin 2020 janë parashikuar për këtë program **297,868,000** lekë dhe objektivi është realizimi i punësimit për 28.000 punëkërkuar të papunë të ndërmjetësuar për punë.

Për vitin 2019 u miratuan për këtë program **298,908,000** lekë dhe për periudhën Janar – Shtator 2019 janë realizuar 23,734 punësime nëpërmjet ndërmjetësimeve për punë, nga zyrat e punësimit në shkallë vendi, nga të cilat 50% janë femra.

## **Programet e nxitjes së punësimit**

Programet e nxitjes së punësimit, të cilat veprojnë drejtpërsëdrejti në grupin e punëkërkuarve të papunë për t'i nxitur ata në gjetjen e një punësimi afatgjatë, me qëllim përfshirjen në këto programe, kryesisht të grupeve vulnerabel.

Për vitin 2020 janë parashikuar për këtë program **390,000,000** lekë, duke synuar të përfshihen deri në 5000 punëkërkuar të papunë.

Për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit për vitin 2019 u miratuan **430,000,000** lekë, 4770 punëkërkuar të papunë dhe deri në fund të vitit mendohet të jetë 4800 pjesëmarrës.

## **Programi i Formimit Profesional**

Programi i formimit profesional synon trajnimin e punëkërkuarve të papunë, të regjistruar në zyrat e punësimit, në kurse afatshkurta 3-9 mujore, në profesione të kërkuara në tregun e punës, të ofruara nga qendrat publike të formimit profesional, për t'i integruar dhe riintegruar ata në tregun e punës.

Për vitin 2020 janë parashikuar **289,770,000** lekë dhe janë planifikuar të trajnohen 17,500 persona, prej të cilëve 11,500 punëkërkuar të papunë në kurse profesionale të kërkuara në tregun e punës.

Për vitin 2019 u miratuan **274,792,000** lekë dhe për këtë periudhë të vitit 2019 janë formuar 14,846 punëkërkuar të papunë, të dërguar nga zyrat e punësimit dhe janë regjistruar e vazhdojnë trajnimin në total 19,589 persona.

## **Programi i Pagesës së Papunësisë**

Programi i pagesës së papunësisë është pjesë e politikave pasive të punësimit, të cilat sigurojnë mbështetjen me të ardhura të papunëve në momentin e daljes së tyre si të tillë, duke synuar krijimin e kushteve për rikthimin e tyre në tregun e punës.

Për vitin 2020 janë miratuar për këtë program **600,000,000** lekë dhe planifikimi është 3,800 persona, përfitues të pagesës së të ardhurës nga papunësia.

Për vitin 2019 ishte miratuar **540,000,000** lekë dhe aktualisht janë në skemën e përfitimit të kësaj pagesës 2,493 punëkërkuar të papunë në zyrat e punësimit, në shkallë vendi.

## **Investimet e zyrave të punësimit**

Për vitin 2020 janë miratuar **67,000,000** lekë të cilat do të përdoren për riformatimin e sistemit informatik të AKPA dhe rikonstruksionin disa zyra të punësimit.

Për vitin 2019 u miratuan **53,400,000** lekë për investimet në zyrat e punësimit, të rikonstruktura dhe organizuara, sipas modelit të ri të shërbimeve të punësimit. Gjatë kësaj periudhe janë rikonstruktuar Zyrat e punësimit në Durrës, Berat, Gjirokastër dhe Malesi e Madhe.

### **Projekt Buxheti për vitin 2020 programi i Arsimit të Mesëm Profesional**

Fondet buxhetore për vitin 2020 për arsimin profesional kanë një rritje prej 9.4 milion lekë në krahasim me vitin 2019 (1%)

Për vitin 2020 buxheti i planifikuar ka rritje në zërat e shpenzimeve:

Në shpenzime korrente buxheti është planifikuar me 169.5 milion lekë më shumë.

Është planifikuar me rritje buxheti për bursat e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin profesional. Për të ngushtuar hendekun gjinor në arsimin profesional për vitin 2020 krahas rishikimit të kurikulave me bazë gjinore, në vendimin e këshillit të ministrave për bursat, tashmë do stimulohen me bursë dhe nxënset (vajzat) që ndjekin drejtimit mësimor tipike për meshkuj (elektroteknikë, gjeodezi, termohidraulike etj)

Në përaftrim me normat e BE-së, është bërë ulja e numrit të orëve për mësuesit e lëndëve profesionale si dhe ulja e numrit të nxënësve për klasë, tregues të cilët ndikojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies në shkollë. Për realizimin e uljes së orëve për mësuesit e lëndëve profesionale për vitin mësimor 2019-2020, është miratuar një shtesë prej 100 mësuesish,

**Në Zërin shpenzime kapitale** janë planifikuar 525.4 milion lekë shpenzime, të cilat do investohen në ndërtimin dhe rikonstruksionin e 9 shkollave dhe bazave prodhuese, si dhe paisjen e reparteve të praktikës profesionale me pajisje dhe makineri, blerje paisje për laboratorët e lëndëve të përgjithshme

Gjatë diskutimeve në komision, deputetët, anëtar të këtij komisioni, bënë pyetje për përfaqësuesit e Ministrisë rreth rikonstruksionit të shkollave profesionale, kualifikimit të mësuesve, zyra të punës, politikat dhe strategjitë e reja, politikat e të rinjve për punësimet e tyre, matësi i tregut të punës, etj., si dhe u hodhën mendime për rialokim të fondeve, të cilat do të trajtohen në komision në shqyrtimin e projektligjit nen për nen.

**Komisioni, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm, miratoi në parim projektligjin dhe ra dakord, që, raporti t'i dërgohet Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.**

**RELATOR**

**Ilirian Pendavinji**

**KRYETAR**

**Enver Roshi**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

### Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë

Tiranë, më 10. 12. 2019

Dokument parlamentar

**(Komision për dhënie mendimi)**

## R A P O R T

### **për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020” (nen për nen)**

Drejtuar: Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, organizoi në datat 20 dhe 21 Nëntor 2019 seancat dëgjimore me shoqërinë civile dhe me datë 5 Dhjetor 2019 shqyrtoi nen për nen projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”.

Të ftuar për të marrë pjesë në mbledhjen e shqyrtimit nen për nen të këtij projektligji dhe për t’iu përgjigjur kërkesave për shtesa apo ndryshime në buxhet të paraqitura nga përfaqësuesit e shoqërisë civile ishin përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave

Projektligji “Për Buxhetin e vitit 2020” është propozim i Këshillit të Ministrave bazuar në nenin 81, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë. Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78, 83, pika 1 dhe 158 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 32-39 dhe 80 të Rregullores, shqyrtoi projektligjin “Për Buxhetin e vitit 2020”, për pjesën që shprehet për shpenzimet dhe të ardhurat për këto ministri.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit nen për nen, ministrinë përkatëse nuk shprehën kërkesa për shtesa, përvec Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e cila kërkoi një ndryshim në tabelën 5 për P/Buxhetin 2020 të kësaj ministrie në funksion të rritjes së cilësisë të shërbimit të urgjencës mjekësore, unifikimin dhe standartizimin e këtij shërbimi, si dhe kualifikimin e personelit që është pjesë e këtij shërbimi, nëpërmjet planifikimit,

drejtimit, pjesëmarrjes dhe bashkërendimit të të gjitha asetëve ekzistuese në një sistem të unifikuar.

Konkretisht në varësi të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore do të kalojnë urgjencat paraspitalore të tre spitaleve universitare të Spitalit Universitar të Traumës, Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi” dhe Qendrës Spitalore “Nënë Tereza”, duke rritur numrin e punonjësve me 122 (nga 86 bëhet 208).

Strukturat e urgjencave mjekësore spitalore të tre spitaleve universitare kalojnë në administrim të Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, së bashku me asetet dhe burimet financiare të planifikuara për këtë shërbim në buxhetin e vitit 2020.

Ky ndryshim nuk ka efekte financiare shtesë për P/Buxhetin e vitit 2020 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pasi bëhen rialokime shpenzimesh korrente brenda tavanit të miratuar.

Sa më sipër ndryshimi në mënyrë të detajuar do të vijë me shkresë nga Ministria përkatëse.

Komisioni, bazuar në nenin 36 dhe 80 të Rregullores, zhvilloi dy seanca dëgjimore publike, me përfaqësues të ministrive të linjës dhe me përfaqësues të Avokatit të Popullit, organizatave jofitimprurëse që veprojnë në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve jetimë, të personave me aftësi të kufizuar, personave që vuajnë nga sëmundja e diabetit, talasemisë, ish-të përndjekurve politikë, organizatave të romëve dhe egjiptianëve, Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë dhe Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë, etj.

Pasi dëgjoi dhe diskutoi mbi propozimet konkrete të bëra nga përfaqësuesit e organizatave jofitimprurëse të sipërpërmendura, dhe konfirmimit nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e cila siguroi që disa nga kërkesat e ngritura prej tyre si: shtesa e 1000 lekëve tek ndihma e invalidëve të punës; shtimi i buxhetit për rikonstruksionin e godinave të amortizuara të shumë spitaleve publike në rrethe si dhe pajisje mjekësore; kite për HIV, kite për sifiliz, gonorea, hepatit B dhe C, materiale laboratorike për kryerjen e testeve për HIV dhe IST; janë parashikuar në buxhetin e vitit 2020, Komisioni ra dakord që t’i rekomandojë Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, që të vlerësojë mundësinë e shtesave të fondeve në projektbuxhet për:

Në programet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:

- Të parashikohet një fond në shumën 4,075,500 për depistimin e dëgjimit neonatal, për të mos hedhur poshtë punën e deritanishme, e cila deri më tani ka funksionuar në bazë projektesh ku vetëm vlera e pajisjeve të vendosura në 4 maternitete dhe QSUT shkon rreth 200.000 Euro.
- Të parashikohen fonde për rimbursimin e mjeteve ndihmëse që ju vijnë në ndihmë invalidëve, të cilat përfshijnë protezat e të gjitha llojeve, aparatet për kardiakët si dhe qeset e kolostomës.
- Të parashikohen fonde për një paketë ekzaminimesh për gratë e vajzat, qoftë edhe për një ekzaminim si PAP test, i cili mund të shpëtojë jetët e atyre, që nuk kanë mundësi financiare ta paguajnë vetë atë.

Në programet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë:



- Fondet për strehimin social të mund të shkojnë për ndërtimin e banesave për familjet rome dhe për lehtësimin e procedurave të përfimit të këtyre banesave sociale.

Komisioni, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, miratoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin për buxhetin e vitit 2020.

**RELATOR**

**Ilirian Pendavinji**

**KRYETAR**

**Enver Roshi**